

VENDIM
Nr.394, datë 28.10.1998

**PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT PARLAMENTAR TË PËRKOHSHËM PËR
DREJTIMIN E REFERENDUMIT PËR KUSHTETUTËN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të ligjit nr.8416, datë 12.10.1998 "Për disa ndryshime në ligjin nr.7866, datë 6.10.1994 "Për referendumet"" dhe të vendimit të Kuvendit Popullor nr.393, datë 21.10.1998 "Për miratimin përfundimtar të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë me Referendum Popullor", me propozimin e Kryesisë,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Për njohjen dhe propagandimin e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, e cila do t'i nënshtrohet për miratim referendumit popullor, krijohet një komision parlamentar i përkohshëm me 9 deputetë, me këtë përbërje:

1. Skënder Gjinushi
2. Sabri Godo
3. Arben Imami
4. Kastriot Islami
5. Vasil Melo
6. Namik Dokle
7. Nikollë Lesi
8. Gramoz Ruçi
9. Fatbardh Hushi

II. Komisioni parlamentar i përkohshëm të hartojë një program pune, ku të përcaktohen masat organizative për njohjen dhe propagandimin e Kushtetutës. Për këtë qëllim ky komision mund të ngrejë nënkomisione dhe grupe pune me specialistë.

III. Shpenzimet e komisionit të përballohen nga fondet e miratuara për Kuvendin Popullor për vitin 1998.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.